

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Ndriçim Kulla - Rama dhe Vuçiq, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane
ADRESA	https://www.syri.net/op-ed/917834/rama-dhe-vucic-dy-vellezerit-siameze-te-dekadences-demokratike-evropiane/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:06:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:00:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	948137abca3566da48b2ab31575a3168a3c453fcb40023e3272fbe0f691b486a
TEKSTI	d57ce14bff82e5de385a3c9e0a0cdc6d6c12ddeb8056771b91bb175a440d1edb
PAMJA	4db0571f59c82d4515871977e09c813db6f38e0f6b676cba636da54cef0dc8e5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67d03f844d8f943be2baacdc6688b7e1ff20148a88de88e5cfa5b9ce64c2359a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67d03f844d8f943be2baacdc6688b7e1ff20148a88de88e5cfa5b9ce64c2359a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane

**PROF. MYQEREM TAFAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!



Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane



Nga Ndrim Kulla - 14:00, 19/09/2026

Historia politike e Ballkanit është plot me aleanca të çuditshme, me armiqësi që shndërrohen papritur në miqësi, me marrëveshje që shpallen historike dhe harrohen sapo ndryshojnë interesat e atyre që i kanë nënshkruar. Megjithatë, rrallëherë ka prodhuar një simetri politike si ajo që prej vitesh mund të vërehet midis Edi Ramës dhe Aleksandar Vuçiçit. Ata nuk janë thjesht dy liderë që bashkëpunojnë në disa çështje rajonale; janë shndërruar në dy figura që, pavarësisht dallimeve të vendeve që drejtojnë, paraqesin një model të ngjashëm të ushtrimit të pushtetit: përqendrimin e autoritetit politik, personalizimin e vendimmarrjes, përdorimin intensiv të komunikimit publik dhe përpjekjen për ta paraqitur stabilitetin si vlerë që qëndron mbi konfliktin politik, mbi kritikën dhe, gjithmonë, mbi kërkesën për llogaridhënie.

Kjo është arsyeja pse metafora e dy vëllezërve siamezë të dekadencës demokratike evropiane nuk duhet kuptuar si një identifikim mekanik i dy sistemeve politike, sepse Shqipëria dhe Serbia kanë histori, institucione dhe orientime ndërkombëtare të ndryshme, por si një përpjekje për të kuptuar një fenomen më të gjerë ballkanik: lindjen e një lloji pushteti diktatorial që nuk ka më nevojë të shfaqet me uniformë ushtarake, me tanke në rrugë apo me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, sepse mund të funksionojë brenda vetë formave të demokracisë, duke ruajtur fasadën e zgjedhjeve, parlamentin, konferencat e shtypit, ceremonitë evropiane dhe gjithashtu fasadën dhe gjuhën e integritit, ndërkohë që kufijtë realë të konkurrencës politike pothuajse nuk ekzistojnë.

Në Serbi, Vuçiç ka ndërtuar gjatë viteve një sistem politik ku ndikimi mbi hapësirën mediatike, dominimi elektoral dhe personalizimi i pushtetit kanë qenë objekt i kritikave të vazhdueshme nga opozita, organizatat e shoqërisë civile dhe institucione ndërkombëtare. Në Shqipëri, Rama, mostra jonë, ka ndërtuar një model tjetër, por me një element të ngjashëm: një pushtet fare të centralizuar rreth figurës së kryeministrit, i cili ka qenë në qendër të jetës politike për një periudhë të gjatë dhe e ka kthyer komunikimin politik në një instrument të rëndësishëm të qeverisjes.

Këtu fillon problemi i vërtetë.

Sepse demokracia nuk vdes gjithmonë kur mbyllen parlamentet; ndonjëherë fillon të zbehet pikërisht kur institucionet vazhdojnë të ekzistojnë, por qytetari nuk beson më se ato mund ta ndryshojnë realisht raportin e pushtetit.

më të lexuarat



'Anëtarësimi i asociuar' Kanada-BE: Çfarë do të thotë për Otavën dhe Evropën



Putini ka një problem me numrin e ushtarëve dhe vetëm një rrugëdalje të rrezikshme



Po përgatisim një brez për të dështuar në shkollë



Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit siamezë të dekadencës demokratike evropiane



Strehim social apo qeverisje imobiliare?



Tradhtia që s'e panë tu ardhë



'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

Kjo është forma moderne e dilemës.

Një demokraci formalisht mund të ketë zgjedhje dhe përsëri të ketë një garë krejtësisht të pabarabartë. Mund të ketë parlament dhe përsëri parlamenti të shndërrohet në vull të shumicës. Mund të ketë drejtësi dhe përsëri të lindë perceptimi se drejtësia funksionon nën presionin e politikës. Mund të ketë media të shumta dhe përsëri hapësira e debatit publik të dominohet nga një qendër e vetme politike, ekonomike ose mediatike.

Prandaj, Rama dhe Vuçiç janë interesantë jo vetëm si dy liderë ballkanikë, por si dy shembuj të një vuajtjeje që Evropa ende nuk e ka zgjidhur: çfarë ndodh kur stabiliteti politik fillon të përdoret si justifikim për tolerimin e përqendrimit të pushtetit?

Evropa ka nevojë për stabilitet në Ballkan. Por stabiliteti nuk është i njëjtë me demokracinë. Një regjim mund të jetë funksional, të prodhojë vendime të shpejta, të jetë partner në negociata dhe të ruajë një marrëdhënie të qëndrueshme të shtirur me Brukselin, pa respektuar vijimësinë e një demokracie të vërtetë. Pikërisht këtu qëndron një nga paradokset më të mëdha të Evropës së sotme.

Dhe pikërisht këtu marrëdhënia Rama-Vuçiç merr një dimension tjetër.

Open Balkan ishte një nga shfaqjet më të dukshme të këtij binjakëzimi politik. Nisma u promovua si projekt ekonomik dhe rajonal për lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, dhe Shqipëria, Serbia e Maqedonia e Veriut nënshkruan marrëveshje konkrete në këtë drejtim. Vetë qeveria shqiptare e paraqiste atë si një mekanizëm për të kapërcyer barrierat dhe për ta afruar rajonin me modelin e tregut evropian.

Por problemi politik nuk ishte vetëm çfarë përmbante Open Balkan-i; ishte edhe kush e prodhonte agjendën e tij dhe mbi çfarë raporti politik ndërtohej ajo.

Sepse një projekt rajonal nuk mund të matet vetëm me numrin e marrëveshjeve ekonomike. Ai duhet parë edhe në raport me Kosovën, me dialogun Kosovë–Serbi, me çështjen e kufijve dhe me ekuilibrat e sigurisë në rajon.

Dhe këtu historia u bë shumë më e ndërlikuar.

Në vitin 2018, Hashim Thaçi e hodhi hapur në debatin politik idenë e "korrigjimit të kufirit" me Serbinë, ndërsa Aleksandar Vuçiç e kishte mbështetur idenë e një marrëveshjeje territoriale. Edi Rama, nga ana e tij si ideatori real i kësaj marrëveshjeje në prapaskenë, nuk e përjashtoi diskutimin për ndryshimin e kufirit; në shtator 2018 ai tha se gjoja nuk e dinte cila ishte zgjidhja më e mirë, por argumentoi se çështja duhej diskutuar dhe nuk e përjashtoi mundësinë e shkëmbimit territorial.

Kjo krijoi një klimë politike jashtëzakonisht të rrezikshme për Kosovën, sepse ajo që duhej të ishte një çështje e vendosur nga institucionet e Kosovës dhe nga një proces i gjerë ndërkombëtar, rrezikonte të shndërrohej në një projekt të drejtuar nga një rreth i ngushtë liderësh.

Pikërisht këtu qëndron edhe një nga dyshimet më të mëdha politike të asaj periudhe: a po kërkohej një marrëveshje historike Kosovë–Serbi, apo po krijohesh një pritshmëri e re politike se zgjidhja do të vinte përmes një formule territoriale që do të hapte njëkohësisht një varg precedentësh të rinj në Ballkan?

Kjo nuk ishte një frikë pa bazë të fortë. Në dokumente dhe analiza të kohës, ideja e "korrigjimit të kufijve" u trajtua si një çështje me pasoja potencialisht shumë më të gjera sesa marrëdhënia mes Prishtinës dhe Beogradit. Debatit për të përfshinte frikën se ndryshimi i kufijve mbi baza etnike mund të krijonte precedent për konflikte të tjera në rajon.

Në këtë pikë, figura e Hashim Thaçit bëhet tragjikisht qendrore dhe e dyshimtë. Kjo nuk mund të harrohet dhe nuk mund të fshihet kurrë.

Sepse Thaçi përfundoi më pas në Hagë, ndërsa historia e tij politike u nda në dy kohë: koha kur ai ishte një nga figurat kryesore të shtetit të Kosovës dhe koha kur u bë i pandehur para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Por këtu duhet të shmangim një tjetër paradoks: nuk mund të thuhet thjesht se Rama "e futi" Thaçin në Gjykatën Speciale. Historia dokumenton diçka më komplekse. Në vitin 2015, Rama mbështeti fuqimisht krijimin e saj dhe deklaroi se besonte se Kuvendi i Kosovës do të merrte vendimin për ta themeluar. Gjykata u krijua përmes ndryshimeve kushtetuese të votuara nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa më pas selia e saj u vendos në Hagë.

Por pikërisht këtu ka shumë për t'u sqaruar më shumë se akuza e drejtpërdrejtë:

Si është e mundur që i njëjti Edi Rama që në vitin 2015 e mbështeste me forcë

krijimin e Gjykatës Speciale, vite më vonë të shndërrohej në një nga kritikët më të zëshëm të mënyrës se si ajo po zhvillonte procesin ndaj Thaçit?

Kjo kthesë është e dokumentuar. Në vitin 2020, pas aktakuzave ndaj Thaçit dhe Kadri Veselit, Rama shkoi në Prishtinë dhe deklaroi se vizita e tij nuk synonte të mohonte nevojën e drejtësisë, por kundërshtonte atë që ai e konsideronte si trajtim të padrejtë të historisë së Kosovës.

Por historia nuk mund të shkruhet vetëm nga pozicioni i fundit i një politikani. Ajo duhet të mbajë përballë njëra-tjetrës të gjitha fazat e qëndrimit të tij.

Dhe këtu metafora e Émile Zolasë bëhet e fuqishme.

J'Accuse...! nuk ishte roman, por një letër e hapur që Émile Zola botoi më 1898 në mbrojtje të Alfred Dreyfosit. Thelbi i saj nuk ishte thjesht mbrojtja e një individi; ishte denoncimi i një mekanizmi institucional që kishte lejuar që një njeri të sakrifikohet për të mbrojtur prestigjin e shtetit, ushtrisë dhe institucioneve. Dreyfusi u bë simbol i njeriut që humbet zërin përballë një sistemi që tashmë e ka shpallur fajtor përpara se e vërteta të triumfojë.

Këtu qëndron fuqia universale e figurës së Dreyfosit.

Ai nuk është i rëndësishëm vetëm sepse ishte Dreyfus. Është i rëndësishëm sepse mund të ishte çdo njeri që gjendet përballë një makinerie më të madhe se vetja.

Por pikërisht për këtë arsye, edhe rasti i Thaçit dhe tre të tjerëve kërkon një dallim të domosdoshëm: mbrojtja e parimit të prezumimit të pafajësisë, e procesit të drejtë dhe e standardeve të drejtësisë nuk është e njëjtë me shpalljen paraprake të pafajësisë së një të pandehuri.

Kjo është edhe ajo që një debat serioz evropian duhet të luajë një rol kyç për një qartësi parimore të këtij problemi.

Sepse më 16 shtator 2026, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë e shpallën Thaçin fajtor për katër vepra penale të lidhura me luftën dhe e dënuan me 25 vjet burg; ndërsa ai ka deklaruar vazhdimisht pafajësinë.

Ky zhvillim i jep një tjetër peshë paqartësisë që kemi përballë: jo "a duhej apo nuk duhej të ekzistonte Gjykata?", por a mund të lejojë Evropa që drejtësia të shndërrohet në instrument të politikës dhe politika të shndërrohet në zëvendësim të drejtësisë?

Sepse të dyja janë të rrezikshme.

Dhe këtu kthehemi te Rama dhe Vuçiç.

Njëri ka ditur të ndërtojë një marrëdhënie të veçantë me Evropën duke e paraqitur veten në mënyrë të manipuluar, ashtu si nuk është, si garant të stabilitetit, integritetit dhe dialogut. Tjetri ka ditur të ndërtojë të njëjtën marrëdhënie duke e paraqitur Serbinë si një aktor që nuk mund të anashkalohet në zgjidhjen e problemeve të Ballkanit.

Në këtë kuptim, të dy këta nuk janë identikë.

Por kanë kuptuar të njëjtën gjuhë politike: Evropës i duhet stabiliteti dhe lideri që e garanton stabilitetin bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u sfiduar.

Kjo është pika ku stabiliteti po kthehet nga një vlerë demokratike në një alibi politike.

Dhe këtu qëndrojnë edhe shqetësimet që duhet t'i paraqesim sot Evropës: nëse një lider kontrollon një pjesë të madhe të sistemit politik, nëse opozita e ka të vështirë të krijojë një alternativë reale, nëse mediat përballen me pabarazi të mëdha, nëse drejtësia mbetet objekt i konfliktit politik dhe nëse Brukseli vazhdon të ketë nevojë për atë lider si partner negociues, ku mbaron pragmatizmi diplomatik dhe ku fillon tolerimi i dekadencës demokratike?

Dhe historia e Zolasë na kujton diçka edhe më të rëndësishme: kur institucionet heshtin, fjala bëhet institucion; kur drejtësia humbet zërin, shkrimtari mund të bëhet dëshmitar; dhe kur një njeri sakrifikohet për të mbrojtur prestigjin e sistemit, pyetja nuk është më vetëm se çfarë i ndodhi atij njeriu, por çfarë i ka ndodhur vetë shoqërisë.

Dreyfusi ishte viktima konkrete e një sistemi që kërkonte të mbronte veten.

Por Zola nuk u mjaftua me Dreyfusin.

Ai akuzoi mekanizmin.

Kjo është arsyeja pse J'Accuse...! vazhdon të jetojë.

Dhe kjo është edhe pyetja që Ballkani duhet t'ia bëjë vetes sot: a po ndërtojmë demokraci që kontrollojnë pushtetin, apo pushtete që mësojnë të duken demokratike?

Dhe kjo është pikërisht drama e dy vëllezërve siamezë të dekadencës demokratike evropiane: ata mund të jenë të ndryshëm në flamuj, në histori dhe në retorikë, por pyetja që ngrihet mbi të dy është e njëjtë – çfarë ndodh me demokracinë kur pushteti fillon ta konsiderojë veten më të rëndësishëm se institucionet që duhet ta kufizojnë atë?

© SYRI.net

Lexo edhe

- » Strehim social apo qeverisje imobiliare?
- » Po përgatisim një brez për të dështuar në shkollë
- » Putini ka një problem me numrin e ushtarëve dhe vetëm një rrugëdalje të rrezikshme

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME



'Anëtarësimi i asociuar' Kanada-BE: Çfarë do të thotë për Otavën dhe Evropën



Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!



'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



Tradhtia që s'e panë tu ardhë



Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



Shtërngimi i gazit në Evropë: Çfarë lloj dimri na pret?



Nga çfarë kanë frikë ekspertët e 'superinteligjencës' së IA?

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.